

VENDIM
Nr. 93, datë 4.7.2017

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “PPC ALBANIA” SHA NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “PPC Albania” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për gatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 72, datë 11.5.2017, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “PPC Albania” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “PPC Albania” sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/8, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “PPC Albania” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5 (pesë)-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti